

## MEMORANDUM

INSTITUTI I STATISTIKAVE

*Nr. 428 Prot.*

MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT  
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

*Prot 2474.*

### MEMORANDUM MIRËKOPTIMI

Ndërmjet:

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

(që këtu më poshtë referohet si "INSTAT")

dhe

**MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

(e cila vepron si Agjenci Statistikore dhe më poshtë referohet si MBZHRAU)

Bazuar në ligjin për Statistikat Zyrtare Nr. 9180, datë 05.02.2004, i ndryshuar, veçanërisht (nenin 8, pika 1, k), Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë Nr. 3/2013, datë 14.02.2013, "Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2012-2016" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 53 datë 21.01.2015 "Për kryerjen e disa aktiviteteve statistikore nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2012-2016".

Duke pasur parasysh që Statistikat Zyrtare Shqiptare drejtohen nga Parimet Themelore për Statistikat Zyrtare të përfshira në Ligjin "Për Statistikat Zyrtare";

Duke pasur parasysh që INSTAT-it i është dhënë një kompetencë e plotë në përgatitjen dhe zbatimin e Statistikave Zyrtare sipas këtyre parimeve;

Duke pasur parasysh që Sistemi Statistikor Shqiptar bazohet në një bashkëpunim të ngushtë mes INSTAT nga njëra anë dhe Agjencive të tjera Statistikore dhe mbajtësve të të dhënave administrative nga ana tjetër;

Duke pasur parasysh që ky bashkëpunim mes aktorëve në fushën e Statistikave Zyrtare duhet të organizohet mbi bazën e memorandumit të mirëkuptimit që mbulon organizimet e punës dhe detyrimet dypalëshe të këtij bashkëpunimi;

Kanë përfunduar këtë:

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

### Hyrje

Ligji “Për Statistikat Zyrtare” (më poshtë “Ligji”; Nenet pa reference të mëtejshme në Ligj) i jep INSTAT-it një kompetencë të plotë në fushën e Statistikave Zyrtare –për përgatitjen dhe zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare. Autoritetet, përveç Institutit të Statistikave, që cilësohen në programin e statistikave zyrtare si të autorizuar të ndërmarrin aktivitete lidhur me prodhimin e statistikave zyrtare marrin pjesë në këto aktivitete si “Agjenci Statistikore” (neni 2/1, f)). Ndërsa baza e bashkëpunimit të këtyre aktorëve në Statistikat Zyrtare caktohet në Ligj dhe në Program, **ky memorandum mirëkuptimi synon të rrisë funksionimin e Statistikave Zyrtare duke bërë më të dukshëm organizimet e punës dhe detyrimet dypalëshe të këtij bashkëpunimi.**

### 1. MANDATI I MINISTRISË SË BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE (MBZHRAU)

1.1 Programi i Statistikave Zyrtare përcakton institucionet përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare dhe afatet kohore për këto aktivitete.

1.2 INSTAT dhe Ministria Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) do të vazhdojnë të forcojnë bashkëpunimin e mirë në fushat statistikore me qëllim që të forcojnë prodhimin e Statistikave të Bujqësisë duke iu përgjigjur kërkesës në rritje të përdoruesve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

1.3 Të gjithë institucionet bashkëvepruese, në kuptimin e Ligjit “Për Statistikat Zyrtare”, do të veprojnë konform përcaktimeve në programin statistikor të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

1.4 Brenda këtij kuadri Ministria Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave vepron si Agjenci Statistikore

1.5 Kompetencat dhe funksionet e MBZHRAU përcaktohen sipas VKM Nr. 53 datë 21.01.2015 “Për kryerjen e disa aktiviteteve statistikore nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2012-2016”.

### 2. PAVARËSIA PROFESIONALE

2.1 Parimet e besueshmërisë, paanshmërisë dhe objektivitetit të statistikave zyrtare në Shqipëri, kërkojnë që Qeveria, Autoritetet Shtetërore, partitë politike dhe grupet e tjera të interesuara, të abstenojnë nga përpjekja për të influencuar në çështje teknike të caktuara (sipas nenit 4/c). Për këtë qëllim, MBZHRAU merr përsipër të mos ndikojë mbi stafin e saj që punon në Agjencinë Statistikore për këto çështje dhe për më tepër, ndërmerr veprime kundër çdo përpjekje për influencim nga autoritetet e jashtme dhe informon INSTAT-in.

2.2 MBZHRAU garanton disponibilitetin e burimeve njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë memorandum.

### 3. GRUPI I PUNËS

3.1 Me qëllim që të sigurohet zbatimi i këtij Memorandumi, brenda një muaji nga data e nënshkrimit, krijohet një grup pune përgjegjës për të koordinuar aktivitetet e palëve.

### 3.2 Ky grup:

- Përbëhet nga të paktën 8 anëtarë të zgjedhur me konsensusin e dy drejtuesve të institucioneve, duke siguruar një pjesëmarrje të barabartë të dy palëve;
- kryesohet nga një përfaqësues i INSTAT dhe një përfaqësues i MBZHRAU;
- mbledhet të premten e fundit të çdo muaji në zyrat e të dy institucioneve në mënyrë të alternuar si dhe në çdo kohë kur kërkohet nga njëra palë;
- mund të ftojë të marrin pjesë në mbledhje edhe ekspertë ose funksionarë jashtë palëve për argumente të veçanta në diskutim;
- Në fund të çdo takimi, formulohen me shkrim shkurtimisht çështjet e trajtuara, qëndrimet e palëve dhe vendimet e marra;
- Grupi informon rregullisht titullarët e të dy institucioneve mbi ecurinë e mbledhjeve dhe propozimet e mundshme.

### 3.3 Grupi ka detyrat e mëposhtme:

- Ndjek zhvillimin e aktiviteteve të përcaktuara duke verifikuar fazë pas faze përputhjen mes objektivave dhe rezultateve të arritura;
- Evidenton shkaqet që mund të pengojnë arritjen e plotë të rezultateve të pritshme; dhe rakordon për përmirësimin e gjendjes;
- I paraqet institucioneve përkatëse propozime për zgjidhjen e problemeve, duke përfshirë dhe modifikimet e mundshme të memorandumit dhe/ose anekseve pjesë të këtij memorandumit;
- Koordinon detyrat lidhur me publikimin e Vjetarit Statistikor të Bujqësisë duke përfshirë vlerësimin e rezultateve, llogaritjen e treguesve finalë dhe kufizimin e të drejtës së autorit për dy institucionet:
  - o Përpilimi i planit të tabelave për publikim;
  - o Analiza e të dhënave;
  - o Niveli i publikimit;
  - o Te dhenat e vitit të parë (vitit t) të jenë të dhëna paraprake;
  - o Botimi i parë i të dhënave të dalë në web dhe do të jenë të dhëna paraprake
- Te dhenat finale do të botohen në vitin (t+2) pasi të jenë marrë rezultatet paraprake të vitit pasardhës t+1.
- Propozon nisma specifike për rritjen profesionale të statistikienëve nëpërmjet kurseve të përbashkëta të trajnimit, pjesëmarrjes afatshkurtër dhe afatgjatë në organizatat partnere ose organizata të tjera kombëtare, pjesëmarrjes në konferenca, seminare dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me statistikat;
- Inicion projekte kërkimore dhe studimore për çështje të veçanta të interesit të përbashkët me objektiv forcimin e bazës shkencore të produktit statistikor të kryer nga dy institucionet;
- Mbikëqyr dhe kontrollon zbatimin korrekt të pikës 6 të Memorandumit.

## 4. UDHËZIMET PËR STANDARTET PROFESIONALE

4.1 INSTAT ka detyrimin të përcaktojë të gjithë përkufizimet statistikore, klasifikimet dhe nomenklaturat në statistikat zyrtare në përputhje me nenin 7, gërma (ë) të Ligjit, dhe të nxjerrë për të gjitha agjencitë statistikore udhëzime për standardet profesionale në prodhimin e statistikave zyrtare, parashikuar në nenin 8/1, gërma (a).

4.2 Udhëzimet në fuqi, të cilat janë rezultat i bashkëpunimit mes dy institucioneve, janë përcaktuar në Aneksin 1 të këtij memorandumi, i cili është pjesë përbërëse e tij.

4.3 MBZHRAU siguron që puna e saj si agjenci statistikore të kryhet në përputhje me udhëzimet.

## **5. E DREJTA E HYRJES DHE SHKËMBIMI I TË DHËNAVE**

5.1 Për prodhimin e Statistikave Zyrtare, MBZHRAU i transmeton INSTAT-it regjistrat, të dhënat si dhe rezultatet e parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare (sipas nenit 6/3 të Ligjit). Gjithashtu, në mbështetje të neneve 8/2, b dhe 13/3, INSTAT-it i jepet e drejta e hyrjes në të dhënat administrative në nivel mikro (individuale) ose ato nivele që është e nevojshme për prodhimin e statistikave, pas kërkesës paraprake me shkrim.

5.2 MBZHRAU dhe INSTAT sigurojnë shkëmbimin e të dhënave prodhuar brenda fushës institucionale respektive për kryerjen e aktiviteteve statistikore objekt i këtij memorandumi.

5.3 Të dhënat që aksesohen dhe shkëmbehen, forma dhe periodiciteti i transmetimit përcaktohen në mënyrë të detajuar në Aneksin 2 e 3 të këtij memorandumi dhe që janë pjesë përbërëse e tij.

5.4 MBZHRAU realizon mbledhjen, hedhjen, pastrimin, kontrollin dhe përpunimin e të dhënave statistikore nën mbikqyrjen metodologjike të INSTAT. Pas përfundimit të proceseve të sipërpërmendura përcjell të dhënat në INSTAT për publikim.

INSTAT duhet të mbështesë MBZHRAU-në për metodologjitë për realizimin e vërtetimeve, trainimet e stafeve në nivel qendror dhe lokal, softet për hedhjen dhe përpunimin e të dhënave. Instat duhet dergoje ne MBZHRAU, te dhenat lidhur me eksport-importet e produkteve bujqesore dhe blegtorale sipas Aneksit 5, bashkëlidhur.

5.5 INSTAT dhe MBZHRAU bashkëpunojnë për përkufizimet dhe aspektet teknike-metodologjike që lidhen me vërtetimet statistikore objekt i këtij memorandumi.

5.6 INSTAT dhe MBZHRAU përcaktojnë modalitetet për trainimet lidhur me aspektet metodologjike në nivel qendror dhe lokal.

5.7 Të dhënat trajtohen nga partnerët e këtij memorandumi në përputhje të plotë me rregullat e konfidencialitetit të parashikuara në nenin 15 të Ligjit. Për të siguruar mbrojtjen efektive të të dhënave, veçanërisht ndaj aksesit të përdoruesve jashtë Agjencisë Statistike, merren të gjitha masat e nevojshme teknike dhe organizative në përputhje me nenin e sipërcituar.

5.8 Të dhënat që aksesohen dhe shkëmbehen mes palëve kanë formë përfundimtare ose paraprake (sipas rastit). Në secilin rast të cituar, forma e dokumentit duhet të parashikohet shprehimisht në formatin mbajtës të tij.

5.9 Formatet e shkëmbimit të të dhënave janë në formë shkresore, në format elektronik, ose kombinimi i këtyre formave, në përputhje me kërkesën e palës së interesuar.

## **6. SIGURIMI I ZBATIMIT TË PËRSHTATSHËM TË PROGRAMIT**

Duke patur parasysh që, INSTAT është përgjegjës për zbatimin e programit statistikor kombëtar, veçanërisht për mbledhjen, përpunimin, shpërndarjen dhe ruajtjen e të dhënave duke përdorur praktikën më të mirë profesionale dhe duke përfshirë parimet shkencore dhe etikën profesionale. Gjithashtu, duke patur parasysh që INSTAT ngarkohet të raportojë çdo katër muaj para Këshillit të Statistikave mbi ecurinë e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare, si dhe i propozon Këshillit të Statistikave çështje për tu diskutuar drejtpërdrejt me drejtuesit e lartë të Agjencive Statistike për të siguruar përmbushjen e standardeve profesionale, palët nënshkruese e rregullojnë bashkëpunimin e tyre si më poshtë:

6.1 MBZHRAU i kërkon miratim INSTAT-it për çdo vrojtim statistikor që parashikohet të drejtohet nga Agjencia e saj Statistike ose nga çdo institucion tjetër nën varësinë e saj. INSTAT-i jep opinionin e tij për projektin brenda gjashtë javëve kalendarike nga marrja në dijeni. Nëse nuk jepet ndonjë përgjigje brenda këtij afati, projekti konsiderohet se është miratuar.

6.2 Procedurat për prodhimin e statistikave nga MBZHRAU ose nga ndonjë institucion nën varësinë e saj, shqyrtohen nga INSTAT. Për të plotësuar këtë detyrim, INSTAT-it i paraqitet në kohë i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe regjistrat përkatës në përputhje me nenin 13/1 të Ligjit. INSTAT merr përsipër të specifikojë informacionin që kërkon brenda një afati të arsyeshëm.

6.3 Me kërkesë të INSTAT-it, MBZHRAU jep informacion mbi ecurinë e detyrave të parashikuara në Programin Zyrtar.

6.4 Afatet për shkëmbimin e të dhënave janë jo më vonë se 45 ditë para datës së parashikuar në PSZ për publikimin e tyre nga INSTAT.

## **7. MODULET ADMINISTRATIVE ME INTERES STATISTIKOR**

Me qëllim që të rrisë përdorimin statistikor të arkivave administrative, MBZHRAU bie dakord me INSTAT-in, nëpërmjet grupit të punës siç përcaktohet në pikën 3, për modifikimin, integrimin dhe dizenjimin e formularëve që përmbajnë informacion statistikor duke siguruar që përkufizimet dhe klasifikimet përkatëse të jenë në përputhje me ato që përdor INSTAT.

## **8. MARRËDHËNIET ME AGJENCITË NDËRKOMBËTARE PËR ÇËSHTJE STATISTIKORE**

- (1) 8.1 INSTAT detyrohet të përditësojë informacionin për marrëdhëniet mes Agjencive Statistike dhe agjencive ndërkombëtare për çështje që lidhen me statistikat zyrtare shqiptare. Për këtë qëllim, MBZHRAU mban INSTAT-in të informuar për të gjitha takimet e parashikuara.
- (2) 8.2 Informacioni do të jepet paraprakisht dhe duhet të pasqyrojë nëse INSTAT-it i kërkohet të marrë rolin e përfaqësuesit të sistemit statistikor shqiptar dhe nëse takimi implikon edhe agjenci të tjera statistikore shqiptare. Bazuar në nenin 7, gërma (f) të Ligjit, INSTAT-i ka detyrimin të përfaqësojë Statistikat Shqiptare.

## **9. MARRËDHËNIET E RREGULLTA TË PUNËS**

9.1 Palët nënshkruese të këtij memorandumi zhvillojnë takime të rregullta tremujore dhe vjetore me drejtuesit e departamenteve të statistikave në ministri si platformë e përhershme për rritjen e bashkëpunimit, për përmirësimin e memorandumit, kur është e nevojshme, me eksperiencën e krijuar gjatë zbatimit në praktikë të Programit të Statistikave Zyrtare. Për rrjedhojë palët marrin në konsideratë propozimet dhe sugjerimet e grupit të punës siç përcaktohet në pikën 3 të Memorandumit.

9.2 Partnerët e memorandumit janë të ndërgjegjshëm që funksionimi i sistemit statistikor nuk mund të sigurohet mjaftueshëm vetëm nga detyrimet ligjore dhe zbatimi i rregullave. Me bindjen e të qenit partnerë dhe me synimin për të arritur një objektiv të përbashkët, palët inkurajojnë stafin respektiv të krijojnë procedura të ngushta bashkëpunimi edhe nëpërmjet një rrjeti joformal takimesh të përhershme pune, me qëllim që të përgatisin zgjidhje të përbashkëta të pranuar në një nivel mundësisht sa më të ulët dhe sa më të shpejtë.

## **9. PËRMIRËSIMET E ANEKSEVE**

9.1 Udhëzimet mbi standardet profesionale dhe të dhënat që do të shkëmbehen ose aksesohen duhet të përditësohen në përpunime me përparimin teknik dhe praktikën e krijuar gjatë zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare. Përmbajtja e anekseve mund të ndryshojë duke marrë në konsideratë angazhimet dhe detyrimet të cilat mund të lindin pas hyrjes në fuqi të këtij memorandumi.

9.2 Kur është e nevojshme, palët përshtasin Anekset duke marrë në konsideratë propozimet dhe sugjerimet e paraqitura nga grupi i punës sipas pikës 3 të Memorandumit.

## **10. INFORMIMI I STAFIT**

Palët nënshkruese marrin përsipër të informojnë stafin e tyre për këtë memorandum dhe të gjitha ndryshimet. Ata marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin në praktike të memorandumit.

## **11. DETYRIMET FINANCIARE**

Secila nga palët merr përsipër të përmbushë, detyrimet financiare që lidhen me aktivitetet brenda kompetencave të tyre.

## **12. DISPOZITA TË FUNDIT**

12.1 Ky memorandum, i hartuar në dy kopje, hyn në fuqi nga data e nënshkrimit dhe mbaron me nënshkrimin e një memorandumi të ri. Në çdo rast, ky memorandum do të verifikohet ose rishikohet me kërkesë të arsyetuar të palëve ose njëres prej tyre.

12.2 Anekset 1, 2, 3,4 dhe 5 në vijim janë pjesë e pandashme e këtij memorandumi.

| 12.3 Çdo marrëveshje e mëparshme mes palëve zëvendësohet nga ky memorandum.

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

  
MIRELA MUÇA

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

| Tiranë, më 31/03/2016



**MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT  
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË  
UJËRAVE**

  
EDMOND PANARITI

**MINISTËR**

Tiranë, më 31/3/2016

